

## Formular për SYLLABUS të Lëndës – Imazhet Dixhitale II – semestri I

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Arteve, DAB, Dizajn i Inovacionit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Imazhet Dixhitale II</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>E obligueshme</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>4</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>4</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>8</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Yllka Fetahaj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>yllka.fetahaj@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<i>Në vitin e katërt të studimeve të fotografisë, studentët do të përqendrohen në thellimin e njohurive të tyre mbi teorinë e ngjyrave, llojet e fotografisë dhe strategjitë për përgatitjen e një karriere profesionale pas diplomimit. Lënda përfshin një studim të avancuar të ngjyrave në fotografi, emocionet që ngjyrat transmetojnë, dhe aplikimet praktike në zhanret kryesore të fotografisë. Puna praktike përfshin krijimin e portfoliove dhe një projekt final fotografik, si dhe praktikë profesionale në kompani, studio ose organizata.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zhvillojë njohuri të avancuara mbi teorinë e ngjyrave dhe emocionet që transmetohen përmes ngjyrave në projekte fotografike.</li> <li>- Të prezantojë studentët me llojet kryesore të fotografisë dhe pionierët e tyre, duke zhvilluar aftësi praktike në secilin zhanër.</li> <li>- Të përgatisë studentët për tregun e punës përmes krijimit të portfoliove, punës praktike dhe projekteve përfundimtare.</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Të kombinojnë dritën dhe ngjyrën në mënyrë harmonike për të përforcuar emocionet dhe mesazhin vizual.</li> <li>-Të arrijnë një shkallë të lartë të prezantimit të punës kreative, përmes krijimit të portfolios profesionale të strukturuar dhe të jenë të përgatitur për të hyrë në tregun e punës.</li> </ul>

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	30	60
Ushtrime teorike/laboratorike	2	30	60
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	1	10	10
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	1	1	1
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	1	1
Projektet, prezentimet, etj	1	2	2
<b>Totali</b>			<b>160</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p><i>Lënda është e përqendruar në kombinimin e leksioneve teorike me praktikën fotografike, duke i dhënë rëndësi të veçantë pjesëmarrjes aktive të studentëve. Ligjëratat do të ofrojnë një bazë të thellë teorike, ndërsa praktikën në studio dhe terren do të ndihmojnë në aplikimin e këtyre njohurive. Diskutimet e hapura dhe debatet kritike do të nxisin shkëmbimin e ideve dhe analizën e punës praktike të studentëve, duke i inkurajuar ata të zhvillojnë një qasje personale dhe krijuese. Për më tepër, studentët do të angazhohen në projekte individuale dhe grupore, vizita në galeri dhe praktikë profesionale, duke përfshirë edhe kritikën ndërtuese nga kolegët dhe profesorët.</i></p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja dhe angazhimi në leksione dhe punë praktike: 30%</li> <li>- Detyra praktike dhe projekte të realizuara gjatë semestrit: 40%</li> <li>- Prezantimi i projektit final dhe portfolioja profesionale: 30%</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Johannes Itten: <i>The Art of Color</i>  Jon Hedgecoe: <i>The Book of Photography</i>  Lou Jacobs JR.: <i>Studio Lighting</i></p>		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<b>Hyrje në planprogram</b> Njoftimi i studentëve me planin e detajuar të vitit akademik, objektivat dhe mënyrën e vlerësimit.
<i>Java e dytë:</i>	<b>Teori: Ligjërime hyrës për llojet dhe temperatura e ngjyrës së dritës.</b> Çka është ngjyra si e shohim ngjyrën.
<i>Java e tretë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Fotografimi i një objekti të përhershëm në tre ndriçime të ndryshme (ditë me diell, dritë e brendshme, dritë me re) duke përdorur preset-et e ndryshme të White Balance
<i>Java e katërt:</i>	<b>Teori: Hyrje në teorinë e ngjyrave:</b> Ngjyrat Primare, Komplementare, dhe Analoge Kuptimi i bazave të teorisë së ngjyrave dhe se si ngjyrat ndërveprojnë mes tyre në fotografi.
<i>Java e pestë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Eksperimentim me përdorimin e ngjyrave primare dhe komplementare në studio dhe terren për të krijuar efekte të ndryshme vizuale.
<i>Java e gjashtë:</i>	<b>Teori: Ngjyrat Monokromatike dhe Primary-Grey</b> Shpjegimi i ngjyrave monokromatike dhe primary-grey dhe ndikimi i tyre në perceptimin emocional të imazheve.
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Eksperimentim me ngjyrat monokromatike dhe primary-grey për të krijuar emocion dhe efekt në imazhe.
<i>Java e tetë:</i>	<b>Teori: Ngjyrat si emocion:</b> Si ndikojnë ngjyrat në emocionet dhe psikologjinë e subjektit. Diskutimi i ndikimit të ngjyrave në emocionet dhe se si përdorimi i duhur i tyre mund të krijojë një përvojë të fuqishme vizuale.
<i>Java e nëntë:</i>	<b>Puna praktike:</b> Zbatimi i teorisë së ngjyrave si emocion në projekte fotografike.
<i>Java e dhjetë:</i>	<b>Shikimi i një filmi dhe analiza e ngjyrave në projekte filmike</b>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b>Essay:</b> Analize dhe diskutim rreth përdorimit të ngjyrave në film për të kuptuar se si ato ndikojnë në emocionet dhe mesazhet vizuale.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b>Teori: Prezantimi i zhanreve të ndryshme të fotografisë, pionerët dhe aplikimi praktik</b> Shpjegimi i llojeve kryesore të fotografisë, duke përfshirë portretin, peizazhin, fotografinë dokumentare, fotografinë e rrugës, modën, fotografinë komerciale, fine art. Diskutimi mbi pionerët dhe ndikimin e tyre në secilin zhanër.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<b>Puna praktike: Praktikimi i zhanreve të ndryshme të fotografisë</b>

	Studentët do të aplikojnë aftësitë e tyre në zhanret kryesore duke realizuar mini-projekte për secilin zhanër.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Vazhdimi praktik i detyrës.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Prezantimi i punimeve, bisedë e hapur me studentë dhe vlerësimi artistik i punimeve.

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<i>Vijimi i rregullt i ligjëratave, angazhimi në klasë dhe realizimi i detyrave brenda afateve janë të detyrueshme për suksesin në këtë lëndë.</i>

## Formular për SYLLABUS të Lëndës – Imazhet Dixhitale II – semestri II

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<b>Java e parë:</b>	<b>Teori: Qasja në tregun e punës post-graduation</b> Diskutim mbi qasjet për të hyrë në tregun e punës pas diplomimit. Strategjitë për të krijuar një portofol profesional, ndërtimi i kontakteve, dhe mundësitë për të punuar në kompani, studio, ose si freelancer. Përgatitja për intervista dhe negociata për kontrata.
<b>Java e dytë:</b>	<b>Teori: Krijimi i portfolios profesionale: Struktura dhe përzgjedhja e punëve</b> Udhëzime për krijimin e një portfolioje profesionale dhe përzgjedhjen e punimeve për prezantim.
<b>Java e tretë:</b>	<b>Puna praktike: Krijimi i portfolios: Organizimi dhe përzgjedhja e imazheve për përfaqësim në tregun profesional.</b>
<b>Java e katërt:</b>	Vazhdimi i punës praktike në portfolio
<b>Java e pestë:</b>	<b>Praktikë profesionale: Puna praktike për një kompani, studio ose organizatë, ku studentët do të zbatojnë aftësitë e tyre në një kontekst profesional.</b>
<b>Java e gjashtë:</b>	<b>Praktikë profesionale: Mbikqyrja e veprimit praktik të punës së studentëve</b>
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Foto trip apo vizitë në ndonjë galeri/studio.</b>
<b>Java e tetë:</b>	<b>Teori: Krijimi i projektit final fotografik: Planifikimi dhe struktura</b> Shpjegimi i kërkesave për projektin përfundimtar dhe planifikimi i tij.
<b>Java e nëntë:</b>	<b>Puna praktike: Realizimi i projektit final fotografik, duke përdorur teknikat e avancuara të mësuara gjatë viteve të studimit.</b>
<b>Java e dhjetë:</b>	Vazhdimi i punës praktike

<b><i>Java e njëmbëdhjetë:</i></b>	Vazhdimi i punës praktike
<b><i>Java e dymbëdhjetë:</i></b>	Prezantimi i projektit final dhe vlerësimi i hapur
<b><i>Java e trembëdhjetë:</i></b>	Prezantimi i punimeve, bisedë e hapur me studentë dhe vlerësimi artistik i punimeve.
<b><i>Java e katërbëdhjetë:</i></b>	Prezantimi i punimeve, bisedë e hapur me studentë dhe vlerësimi artistik i punimeve.
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></b>	Pregaditja për ekspozitën e fundvitit.

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
--

<i>Vijimi i rregullt i ligjëratave, angazhimi në klasë dhe realizimi i detyrave brenda afateve janë të detyrueshme për suksesin në këtë lëndë.</i>
--